

REPUBLIC OF KOSOVO		REPUBLIC OF KOSOVO	
AGENCIJA ZA VEPRIMET DOKUMENTARE		AGENCIJA ZA VEPRIMET DOKUMENTARE	
KOSOVA DOCUMENTS AGENCY		KOSOVA DOCUMENTS AGENCY	
Tip	0PK/OMP	W. Post	03-4397/13
Udh. No.		Post No.	
Udh. Nr.	02	Datim	23.12.2013
Udh. Nr.		Datim	
Udh. Nr.		Datim	

Regj.nr.17967/12

GJYKATA THEMELORE NE GJILAN,Departamenti I pergjithshem-Divizioni I kundervajtjes,sipas Gjykatesit Veli Kryeziu,kunder te pandehures Bahrije Veseli nga Gjilani,Lagja Arbëria,p.n.per shkak te kundervajtjes nga neni 17 p.1.3,te Ligjit nr.04/L-50 te Ligjit per deklarim,Prejardhjen dhe kontrollin e pasurise te zyrtarve te lart public,e ne baze te nenit 73,74,195 dhe 9 te Ligjit mbi kundervajtjet,me date 20.06.2013 muar kete :

AKTVENDIM

E pandehura **Bahrije Veseli** nga I ati Bilall e lindur me 20.04.1958 ne Ujmir Komuna e Klinës tani me vendbanim ne Gjilan,Lagja Arbëris pn.,shqiptare ,shtetase e Republikes se Kosoves,me profesion punetor ne Arsim e vejë,e gjendjes se mesme ekonomike,kinse nuk eshte I denuar e as ne hetime

ËSHTË PERGJEGJËS

Sepse me date 01.11.2012 eshte konstatuar se I njeiti me kohe nuk e deklaruar formularin mbi deklarimin e pasurise,nuk e k ambush numrat personal te antarve te familjes, si zyrtare I lart per deklarimin e pasurise,sepse si keshilltare e KK Gjilan,pas afatit ligjor nuk e permbush kete obligim Ligjor. Me qka ka kryer veper kundervajtese nga neni 17.al.1.3,Per deklarimin,Prejardhjen dhe kontrollin e Pasurise dhe te zyrtarve te larte Publik.,dhe per ate shpallet pergjegjes dhe

DENOHET

ME DENIM ME GJOBË ne Shumen prej 500 (Pesqid euro),te cilen gjobe I pandehuri eshte I obliguar ta paguaj ne afate prej 15 ditesh nga dita e plotefuqishmerise se ketij Aktvendimi ne te kunderten,gjoba do te zavendsohet ne denim burgu kun je dite burgu ka per tiu llogaritur 20 euro. Obligohet I pandehuri qe ne emer te paushallit gjyqësor të paguaj prej 5 euro,ne afatin e njejtë si dënimi me gjobë.

Arsyetim

Agjensioni kundër kurupsionit me kerkesen e vetë nr. 01-3941/12 te datës 02.11.2012 ka kerkuar qe kunder te pandehures te zhvillohet procedura dhe të ndeshkohet sipas Ligjit.

Gjykatësi i divizionit te kundervajtjes duke u bazuar ne Ligj,thirri te pandehuren i cili me date 13.06.2013 u deklarua ne lidhje me veperen kundervajtese e i cili ne deklaraten e vete nder të tjera ka theksuar:Se të dhënat në kërkesë janë të sakta,por që djali që studijon ne Gjermani nuk kam mundur ti jap shënimet e tij personale sepse nuk i kam ditur e ashtu edhe vajza e cila është e martuar dhe jeton ne Norvegji nuk i kam ditur shenimet personale të saja,për këtë e ndi veten fajtor dhe shprehi keqardhje per këtë lëshim

Pasi që pandehura e ka pranuar ne tersi kundervajtjen e bërë,gjykatësi nuk pati nevojë të shtjelloj prova tjera,andej e shpalli përgjgjës për veperen kundervajtëse dhe i shqipto nje denim sa ma të butë,si në

-2-

dispozitiv të këtij Aktvendimi dhe ate duke u bazuar ne nenin 17,p1, të Ligjit Per deklarimin,Prejardhjen dhe kontrollin e Pasurise dhe te zyrtarve te larte Publik.

Me rastin e matjes së së dënimit me gjobë,gjykata me kujdesë vlersoi mbrojtjen e të pandehuresit si dhe shkresat e lëndës duke u bazuar ne rethanat lehtësuese dhe renduese në lidhje me vepren kundërvajtëse në fjalë.Andej duke e zbatuar nenin 9 të LMK-së Gjykatësi zbuti jashtezakonisht denim e parapar ligjor ,duke mar parasysh se ky është denim I pare dhe se ne të ardhmen është deklaruar se nuk do të kryej veper tjeter të llojit të njejt,është punëtor arsimor,dhe se nuk do të përsrisë kundërvajtjen e tillë,kurse si rethan renduese u muar pasha e kundërvajtjes dhe I shqiptoi kete denim,I bindur se edhe me kete denim ka për tu arritë qëllimi I dënimit tek I pandehuri,Vendimi mbi paushallin gjyqësor u muar në bazë të nenit 109 par.1 të Ligjit mbi kundervajtjet,

Me sa u tha me lartë u vendosë sin ë dispozitiv të këtij aktvendimi.

**GJYKATA THEMELORE NË GJILAN-DIV.KUNDËRVAJTJES
ME 24,04,2013**



Gjyqëtar
Veli KRYEZIU

UDHËZIMI MBI MJETIN JURIDIKË :Kundër këtij Aktvendimi eshte e lejuar ankesa Gjykatës së Apelit në Prishtinë ,Divizionit për kundërvajtje,ankesa dorëzohet perms këtoj Divizioni.